



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:112592

Datë: 28.03.2024

Numri i dokumentit: 05519465

C.nr. 1033/2018

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil, me gjyqtaren Florije Qerimi dhe bashkëpunëtoren profesionale Teuta Gashi, duke vendosur në çështjen juridike kontestuese të paditësit L D nga Gj, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Donat Huruglica avokat nga Gjilani, kundër të paditurit L G nga fshati R, Komuna e K, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Arbër Spahiu avokat nga Gjilani, me bazë juridike Kompensim i dëmit material dhe jo material, në shqyrtimin gjyqësor publik të mbajtur me datë 21.02.2024 mori, ndërsa më datën 26.03.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit L D nga Gj kundër të paditurit L G nga fshati R, Komuna e K dhe DETYROHET i padituri, që paditësit në emër të lëndimeve të pësuar me datë 10.03.2018, nga i padituri L G, së bashku me V Xh, t'ia kompensoj dëmin material dhe jo material, edhe atë:

a. Për dëmin jo material:

- në emër të dhimbjeve fizike të përjetuara në shumën prej 1,000.00 euro;
- në emër të zvogëlimit të përgjithshëm të aktivitetit jetësor prej 3%, në shumë prej 150.00 euro;
- në emër të frikës së përjetuar, të ia paguaj shumën prej 1,000.00 euro;

b). Për dëmin material:

- në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj në kohëzgjatje prej 2 jave nga 10 euro në ditë, shumën prej 140 euro;
- në emër të ushqimit të përforcuar për 2 javë nga 9 euro në ditë, shumën prej 126 euro;

II. DETYROHET e paditura që paditësit t'ia paguaj shumën prej 2,150.00 në emër të kompensimit të dëmit jo material me kamatë ligjore prej 8% nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi me datën 21.02.2024, e në emër të kompensimit të dëmit material shumën prej 266.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë me datë 04.12.2018, e deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.

III. REFUZHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit mbi shumat e aprovuara në lartësi prej 16,780.00 euro, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

IV. DETYROHET i padituri që në emër të shpenzimeve të procedurës, t'ia paguaj paditësit shumën e përgjithshme prej 849.60 euro, në afat prej 15 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me detyrim.

A r s y e t i m

Paditësi L D nga Gj, me datë 14.12.2020, përmes përfaqësuesit të tij ka paraqitur padi kundër të paditurit L G nga fshati R, Komuna e K dhe Vn Xh nga Gj, me objekt kontesti kompensim i dëmit material jo material.

Ndërsa në seancën e datës 10.08.2023, paditësi përmes përfaqësuesit të tij e ka tërhequr padinë kundër të paditurit V Xh nga Gj, në pamundësi të sigurimit të prezencës së tij dhe pagesës për përfaqësues të përkohshëm.

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse:

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij, në padi, gjatë shqyrtimeve gjyqësore, si dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se më datë 10.03.2018, rreth orës 23:30 minuta, i padituri Leutrim së bashku me V Xh, në hyrje të kafiterisë "M", si punëtorë të sigurimit fizik, pranë Kompanisë "Rojet e Nderit", i kanë shkaktuar lëndime të rënda trupore paditësit, i cili për shkak të lëndimeve të pësuar është detyruar të kërkojë ndihmë mjekësore pranë Spitalit të Përgjithshëm në Gjilan dhe i njëjti ka vazhduar shërimin edhe për një kohë të gjatë, fakt ky që vërtetohet përmes raporteve mjekësore, si dhe përmes Aktgjykimit Penal P.nr. /18 i datës 03.05.2018, i cili është bërë i plotfuqishëm me datë 29.08.2018.

Andaj, gjykatës i ka propozuar që të aprovohet padia dhe kërkesëpadia e paditësit dhe të detyrohet i padituri L G, që paditësit t'ia kompensojë dëmin e shkaktuar në ½ pjesë të lartësisë së tij, si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës dhe atë: në emër të ushtrimit të padisë shumën prej 104.00 euro, në emër të taksës gjyqësore shumën prej 40.00 euro, në emër të 3 seancave të mbajtura me nga 270.40 euro për një seancë, gjithsej 811.20 euro, në emër të një seance të shtyrë shumën prej 135.20 euro, si dhe në emër të dy ekspertizave shumën prej 300.00 euro, e në shumë të përgjithshme prej 1,390.20 euro.

Përfaqësuesi i të paditurit në përgjigjen në padi, shqyrtimet gjyqësore dhe në fjalë përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi, duke theksuar se nga të gjitha provat e administruara është vërtetuar se në shkaktimin e dëmit kanë marrë pjesë i padituri L G dhe personi i tretë V Xh të cilët në bashkëkryerje e kanë kryer veprën penale të lëndimit të rëndë trupor për çka edhe janë shpallur fajtor dhe janë dënuar penalisht, andaj si të paditur në këtë raport civilo-juridik të natyrës detyrimore duhet të jenë të dy bashkëkryerësit ngase sipas dispozitave ligjore kemi të bëjmë me bashkëndërgjyqësi unike dhe të domosdoshme, e në rastin konkret paditësi me vullnetin e tij është tërhequr nga pjesa e padisë sa i përket personit të tretë i cili është bashkëkryerës dhe është dashur të mbetet në procedurë pasi që përgjegjësia e të dyve është solidare andaj i padituri Leotrim Geci nuk mund të

detyrohet në kompensimin e pjesës së shpenzimeve për dëmin që e ka shkaktuar edhe personi tjetër. Andaj i njëjti i ka propozuar gjykatës që të refuzojë padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës dhe atë: për përgjigje në padi në shumë prej 208.00 euro, për dy seanca të mbajtura me nga 135.00 euro e në shumë të përgjithshme prej 343.00 euro.

Gjykata për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridiko civile në procedurën e të provuarit i ka administruar këto prova: Raportet e Emergjencës lëshuar nga SPGJ i datës 15.03.2018 me nr te protokollit 5313 dhe 5609; Aktgjykimi Penal P.nr.326/2018 i datës 03.05.2018; Raportet specialistike në bazë të cilave janë nxjerrë edhe ekspertizat e ekspertëve ortoped dhe psikiatër; Raporti mjekësor i ekspertit ortoped Dr.Avdylatif Latifi i datës 19.09.2023; Raporti mjekësor i ekspertit psikiatër Dr.Afrim Cana i dt 19.09.2023; Plotësimi i ekspertizës nga Dr.Afrim Cana i datës 25.01.2024.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, në mbështetje të dispozitave të nenit 8 të LPK-ës, arriti në përfundim se në këtë çështje juridike civile, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij atgjykimi.

Nga raportet e Emergjencës lëshuar nga SPGJ i datës 15.03.2018 me nr. te protokollit 5313 dhe 5609, gjykata vërtetoi faktin se paditësi L D me datë 11.03.2018 dhe 14.03.2018 ka kërkuar ndihmë mjekësore pranë Qendrës Emergjente të Spitalit të Përgjithshëm në Gjilan, si pasojë e lëndimeve të marra nga rrahja.

Nga Aktgjykimi Penal P.nr.326/2018 i datës 03.05.2018, gjykata vërtetoi faktin se i padituri L G dhe personi i tretë V Xh janë shpallur fajtor dhe janë dënuar me vendim të formës së prerë për veprën penale Lëndim i rëndë trupor nga neni 189 paragrafi 1, nën paragrafi 3 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, me dënim me burg në kohëzgjatje prej 150 ditë, për shkak se me dashje paditësit Lm D i kanë shkaktuar lëndime të rënda trupore, i cili për shkak të lëndimit kërkon ndihmë mjekësore në Spitalin e Përgjithshëm në Gjilan, në Qendrën Emergjente.

Nga raportet specialistike në bazë të cilave janë nxjerrë edhe ekspertizat e ekspertëve ortoped dhe psikiatër, gjykata vërtetoi faktin se paditësi L D ka kërkuar ndihmë mjekësore për shkak të lëndime të pësuar.

Nga raporti mjekësor i ekspertit ortoped Dr.Avdilatit Latifi i datës 19.09.2023, si dhe dëgjimi i tij në seancën e datës 20.02.2024, gjykata vërtetoi faktin se paditësi Luftim Dalipi, ka pësuar thyerje të ashtit të hundës pa dislokim, të cilat dëmtime kanë qenë të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë, të furishëm dhe të rëndë mbretës (jo i mprehtë), dhe si të tilla bëjnë pjesë në *dëmtime të rënda trupore*, të cilat pasojnë me dhimbje të intensitetit posaçërisht të lartë 10 minuta, intensitetit të lartë 2 orë, intensitetit të mesëm 15 ditë, intensitetit të ulët 6 javë, po ashtu paditësit i është dashur ndihma dhe kujdesi i huaj dy javë, ushqimi i përforcuar dy javë, shërimi klimatik-fizioterapeutik 10 ditë, si dhe zvogëlimi i përgjithshëm i aktivitetit jetësor 3 %.

Nga raporti mjekësor i ekspertit psikiatër Dr.Afrim Cana i datës 19.09.2023, dhe plotësimi i ekspertizës i datës 25.01.2024, si dhe dëgjimi i tij në seancën e datës 20.02.2024, gjykata vërtetoi faktin se bazuar në dokumentacionin ekzistues paditësi ka pësuar lëndime të rënda trupore si: thyerje e ashtit të hundës pa dislokim, ndrydhje të kokës dhe trupit dhe çrregullim i stresit pas traumës (trajtimi nga shtatori deri në nëntor 2018), nga aspekti psiko-fiziologjik jeta normale e paditësit është prishur për një periudhë kohore si dhe aspekti i frikës nuk përjashtohet, ku frika primare e intensitetit të lartë ka një kohëzgjatje 1 minutë, kurse ajo e intensitetit të mesëm dhe të ulët rreth 2 minuta. Frika primare konsiderohet që përjetohet si emocion gjatë shfaqjes (manifestimit), të fatkeqësisë në trafik, apo lëndimit në vendin e punës por edhe pas momentit të lëndimit të pësuar sikur edhe pas fatkeqësisë, dhe kështu ajo interpretohet si një përgjigje afektive ndaj rrezikut direkt. Lidhur me frikën sekondare e cila manifestohet më pastaj, pra është ngushtë e lidhur me periudhën e rikuperimit të plotë fizik por edhe psikik nga lëndimet e fituara, në rastin konkret kjo frikë ka qenë prezentë për 3 muaj. Karakteristikë e frikës sekondare po ashtu është edhe mundësia që ajo të ketë ndikim direkt në prishjen apo dëmtimin e baraspeshës psikike gjatë periudhës kohore që përfshinë rikuperimin e plotë.

Baza ligjore:

Gjykata, në këtë çështje kontestimore ka aplikuar dispozitat e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, që në nenin 2, paragrafi 1 përcakton se “Pjesëmarrësit në marrëdhëniet e detyrimeve janë të lirë, që në pajtim me dispozitat urdhëruese, të rendit publik dhe të dokeve të mira, t’i rregullojnë marrëdhëniet e veta sipas vullnetit të tyre, neni 9 se “Secili person ka për detyrë të përmbahet nga veprimi që mund t’i shkaktoj dëm tjetrit”; nenin 136, paragrafi 1 dhe 2 se “Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij. Për dëmin nga sendet ose nga veprimtaritë, nga të cilat rrjedhë rreziku i shtuar i dëmit për rrethin përgjigjet pavarësisht nga fajti”; në nenin 137 se “Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikuajt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)”; nenin 140 se “Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia”, nenin 169, paragrafin 1 dhe 2 se “Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi. Në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin, personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të japë shpërblimin në të holla”; nenin 183, paragrafi 1 dhe 2 “Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material. Me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me te mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror” dhe

nenin 358, paragrafi 1, i LMD-së, ku shprehimisht thuhet se “kur dëmi është shkaktuar me vepër penale dhe për ndjekjen penale është parashikuar një afat më i gjatë parashkrimi, kërkesa për shpërblim të dëmit ndaj personit përgjegjës parashkruhet kur të skadojë koha e caktuar për parashkrimin e ndjekjes penale”.

Vlerësimi përfundimtar i gjykatës:

Për gjykatën nuk ishte kontestues fakti se paditësit i janë shkaktuar lëndime të rënda trupore në bashkëkryerje me L G dhe V Xh, ashtu që, si pasojë e një mosmarrëveshjeje verbale, të pandehurit (këtu L G) dhe personi i tretë me emrin V Xh, e godasin të dëmtuarin (këtu paditësin) me shkelma në fytyrë, fakt ky i vërtetuar edhe përmes aktgjykimit penal të ofruar nga ana e paditësit si provë materiale kësaj gjykate. Gjithashtu, për gjykatën, nuk ishte kontestues as fakti se si pasojë e lëndimeve të marra nga ana e goditjeve të personave të lartëcekur, paditësit i është shkaktuar dëm material dhe jomaterial, gjë e cila vërtetohet edhe nga raportet mjekësore që paditësi i ka ofruar gjykatës për vërtetimin e pretendimeve të tij të paraqitura përmes padisë. Për gjykatën ishte kontestuese lartësia e shumave të kërkuara nga ana e paditësit në padi si dhe të sqaruarit e asaj se a përbën bashkëndërgjygjësi unike dhe a duhet të jetë palë e domosdoshme në procedurë personi i tretë i quajtur V Xh për të cilin paditësi kishte tërhequr padinë, e që me paraqitje të padisë, i njëjti kishte figuruar në cilësinë e palës së paditur të paraqitur me padi.

Gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke ia aprovuar pjesërisht të bazuar kërkesëpadinë paditësit, pasi gjeti se më datë 10.03.2018 rreth orës 23:30 minuta, i padituri L G së bashku me personin e tretë V Xh, në hyrje të kafiterisë “M”, si punëtorë të sigurimit fizik, pranë Kompanisë “Rojet e Nderit”, i kanë shkaktuar lëndime të rënda trupore paditësit, i cili për shkak të lëndimeve të pësuar është detyruar të kërkojë ndihmë mjekësore pranë Spitalit të Përgjithshëm në Gjilan, dhe i njëjti ka vazhduar shërimin edhe për një kohë të gjatë.

Fajësinë e të paditurit L G së bashku me personin e tretë V Xh, gjykata e gjeti nga Raportet e Emergjencës lëshuar nga SPGJ të datës 15.03.2018 me nr. të protokollit 5313 dhe 5609, dhe nga Aktgjykimi Penal P.nr. /18 i datës 03.05.2018, i cili është bërë i plotfuqishëm me datë 29.08.2018, ku i padituri L G dhe personi i tretë V Xh janë shpallur fajtor dhe janë dënuar me vendim të formës së prerë për veprën penale Lëndim i rëndë trupor nga neni 189 paragrafi 1, nën paragrafi 3 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, me dënim me burg në kohëzgjatje prej 150 ditë, për shkak se me dashje paditësit L D i kanë shkaktuar lëndime të rënda trupore, të administruara si prova në këtë çështje kontestimore, por ka kontestuar se shuma e kërkuar nga paditësi në emër të shpërblimit të dëmit, është vlerësuar se është më e lartë sesa vëllimi i dëmit të shkaktuar.

Nga kjo gjendje faktike, gjykata fillimisht ka vërtetuar faktin se i padituri është përgjegjës për shpërblimin e dëmit të shkaktuar paditësit në ½ e lartësisë së tij (i njëjti ka qenë pjesëmarrës në lëndimet e pësuar të paditësit së bashku me të gjykuarin V Xh) si pasojë e goditjeve (neni 140, 169 i LMD-së), pastaj është

lëshuar në vërtetimin e faktit se çfarë dëmi i është shkaktuar paditësit, në çfarë vëllimi dhe në cilat lloje.

Deri te ky konstatim, gjykata erdhi duke u bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar si më lartë dhe dispozitat ligjore në fuqi, edhe atë se shkaktuesi i dëmit kompenson të dëmtuarin (neni 136 i LMD-së); se shkaktuesi i dëmit përgjigjet sipas fajësisë dhe kontributit (neni 140 dhe 176 i LMD-së); dhe dëmi jomaterial (dhembje fizike dhe frikë) shpërblehet në të holla ky dëm i shkaktuar (neni 172 dhe 179 i LMD-së).

Gjykata ia fali në tërësi besimin ekspertizave të administruara në këtë çështje kontestimore, edhe atë ekspertizës ortopedike dhe të psikiatrisë, pasi gjeti se të njëjtat janë punuar nga specialistët e fushave përkatëse, janë punuar në mënyrë profesionale dhe i janë përgjigjur çështjeve të parashtruara nga të njëjtit duke përdorur metodat e ekzaminimit të dokumentacionit mjekësor, (ekspertiza e ortopedisë dhe ekspertiza e psikiatrisë).

Me këto prova të administruara gjykata për dëmin jo material, aprovoi kërkesëpadinë me sa vijon: në emër të dhimbjeve trupore-fizike, të të gjitha intensiteteve shumën prej 1,000.00 euro; në emër të zvogëlimit të përgjithshëm të aktivitetit jetësor prej 3%, në shumë prej 150.00 euro; në emër të frikës së përjetuar, të ia paguaj shumën prej 1,000.00 euro; në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj në kohëzgjatje prej 2 jave nga 10 euro në ditë, shumën prej 140 euro; në emër të ushqimit të përforcuar për 2 javë nga 9 euro në ditë, shumën prej 126 euro apo shumën prej 2,150.00 në emër të kompensimit të dëmit jo material si dhe në emër të kompensimit të dëmit material shumën prej 266.00 euro.

Gjykata sa i përket natyrës së lëndimeve, shkallës dhe intensitetit të dhimbjeve fizike, frikës së përjetuar, konstatoi se paditësi ka pësuar lëndime trupore të rënda të cilat pasojnë me dhimbje të intensitetit posaçërisht të lartë 10 minuta, intensitetit të lartë 2 orë, intensitetit të mesëm 15 ditë, intensitetit të ulët 6 javë, po ashtu paditësit i është dashur ndihma dhe kujdesi i huaj dy javë, ushqimi i përforcuar dy javë, shërimi klimatik-fizioterapeutik 10 ditë, si dhe zvogëlimi i përgjithshëm i aktivitetit jetësor 3 %, pastaj paditësi ka pësuar thyerje të ashtit të hundës pa dislokim, ndrydhje të kokës dhe trupit dhe çrregullim të stresit pas traumës ku nga aspekti psiko-fiziologjik jeta normale e paditësit është prishur për një periudhë kohore si dhe aspekti i frikës nuk përjashtohet, ku frika primare e intensitetit të lartë ka zgjatur 1 minutë, kurse ajo e intensitetit të mesëm dhe të ulët rreth 2 minuta, ndërsa frika sekondare ka qenë prezentë për 3 muaj.

Sa i përket lartësisë së kërkesave, gjykata vendosi si në pikën I të këtij dispozitivi, ndërsa refuzoi pjesën tjetër mbi shumën e aprovuar si në pikën II të këtij dispozitivi, pasi vlerësoi se shumatat e kërkuara nga paditësi nuk pasqyrojnë një shumë që i përgjigjet realisht këtyre dëmeve, tërë kjo duke u mbështetur praktikave të deritanishme. Gjykata ka parasysh se me shkaktimin e dëmit te paditësi, asnjë shumë nuk do të rivendos gjendjen e mëparshme të dhembjeve të përjetuara nga ana e tij, mirëpo njëkohësisht gjykata është e thirrur të gjejë një shumë që nuk do të tejkalonte qëllimin për çka kompensohet kjo shumë, ashtu që qëllimi i këtij kompensimi nuk konsiston në pasurim të të dëmtuarit, por që të arrijë një satisfaksion, në atë

masë që paditësi të bëjë ekuilibrimin e gjendjes së tij shpirtërore dhe për aq sa mundet sanimin e të mirës së cenuar. Këto shuma të gjykuara janë në përputhje të plotë me natyrën e të mirës së cenuar dhe qëllimit shoqëror për kompensimin e dëmit material dhe jo material, duke u bazuar edhe sipas mendimeve të ekspertëve mjekësor ortoped-traumatolog dhe psikiatër.

Gjykata vlerën e shumave të theksuara si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi e mori duke u bazuar në Udhëzuesin për Caktimin e Kritereve Orientuese dhe Lartësisë së Shpërblimit të Drejtë në të Holla të Dëmit jo material të nxjerrë nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, me nr.41/2023, të datës 27.02.2023, ashtu që bazuar në kriteret për caktimin e shumave të kërkuara si në padi, gjykata e zvogëloi shumën bazuar në udhëzuesin në fjalë.

Nga të gjitha të theksuarat më sipër, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi vlerësoi se shuma e kërkuar nga paditësi pjesërisht pasqyron një shumë që i përgjigjet realisht këtyre dhembjeve, tërë kjo duke u mbështetur praktikave të deritanishme. Gjykata ka parasysh se me shkaktimin e dëmit të paditësi, asnjë shumë nuk do të rivendos gjendjen e mëparshme të dhembjeve të përjetuara nga ana e tij, mirëpo njëkohësisht gjykata është e thirrur të gjejë një shumë që nuk do të tejkalonte qëllimin për çka kompensohet kjo shumë, ashtu që qëllimi i këtij kompensimi nuk konsiston në pasurim të të dëmtuarit, por që të arrijë një satisfaksion, në atë masë që paditësi të bëjë ekuilibrimin e gjendjes së tij shpirtërore dhe për aq sa mundet sanimin e të mirës së cenuar. Këto shuma të gjykuara janë në përputhje të plotë me natyrën e të mirës së cenuar dhe qëllimit shoqëror për kompensimin e dëmit jo material, duke u bazuar edhe sipas mendimeve të ekspertëve mjekësor ortoped dhe psikiatër.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e të autorizuarit të të paditurit, avokatit Arbër Spahi u nga Gjilani, i cili ka theksuar se në kuadër të këtij raporti materialo juridik, duhet me patjetër të jetë pjesëmarrës edhe personi i tretë i quajtur V Xh (i cili ka qenë i paraqitur në cilësinë e të paditurit me padinë fillestare), ngase sipas dispozitave të LMD-së, kemi të bëjmë me bashkëndërgjygjësi unike dhe të domosdoshme, ashtu që, në rastin konkret paditësi ka tërhequr padinë ndaj të padituri – tashmë personit të tretë me emrin V Xhe, i cili po ashtu është bashkëndërgjygjës dhe i njëjti është dashur të mbetet “*patjetër*” në këtë procedurë, pasi që, përgjegjësia e tyre e të dyvë është solidare, andaj i padituri L Gi, nuk mund të detyrohet në kompensimin e pjesës së shpenzimeve për dëmin që ka shkaktuar edhe personi tjetër, për çka gjykatës një arsyetim i tillë i është dukur irelevant, ndaj edhe ka gjykuar çështjen juridiko civile duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata ka gjetur se paditësi është i lirë të vendos se cili subjekt i së drejtës do të jetë në cilësinë e palës së paditur, si dhe është e drejtë e paditësit që të tërheq padinë ndaj njërit të paditur dhe të vazhdoj padinë ndaj të paditurit të dytë apo anasjelltas, ashtu që, kjo e drejtë që i atribuohet atij, nuk mund ta detyroj gjykatën që në veprimet procedurale të saj, të krijoj detyrueshmëri për palën paditëse duke ndikuar në vullnetin e kësaj të fundit që të përcaktoj se cili nga subjektet procedurale duhet të jetë pjesë e procesit kontestimor, përveç rasteve kur gjykata çmon se duhet rregulluar çështja e legjitimitetit të palëve.

Lidhur me pretendimin se në rastin konkret kemi të bëjmë me bashkëndërgjyqësi unike meqë ngjarja e paraqitur me padi buron nga e njëjta bazë juridike dhe faktike, për gjykatën nuk përbën bazament të asaj se në mënyrë të patjetërsueshme duhet të jenë të dy të paditurit pjesë e kësaj çështje juridiko kontestimore, kjo edhe për faktin se bazuar në nenin 261.1 të LPK-së në të cilin shprehimisht theksohet se paditësi mund të tërheq padinë ndaj të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi, për çka gjykata edhe lejoj tërheqjen e padisë ndaj të paditurit të dytë, duke vazhduar procesin kontestimor vetëm me të paditurin e parë, duke u nisur nga fakti se e njëjta nuk mund të detyrojë paditësin të implikoj në cilësinë e të paditurit, subjekte të cilat ky i fundit nuk dëshiron të marrin pjesë në këtë proces kontestimor, andaj edhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata ka vendosur si në pikën e II të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, përtej shumave të gjykuara duke u bazuar në Udhëzuesin për Caktimin e Kriteve Orientuese dhe Lartësisë së Shpërblimit të Drejtë në të Holla të Dëmit Jomaterial të nxjerrë nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, me nr.41/2023, të datës 27.02.2023.

Gjykata për kamatën ka vendosur duke u bazuar në dispozitën e nenit 382 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, e që është në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, nr. 265/2020, të datës 02.12.2020, pasi që me këtë mendim janë sqaruar dispozitat ligjore për gjykimin e kamatës në çështjet që kanë të bëjnë me kompensimin e dëmit jo material, pavarësisht se kur ka lindur marrëdhënia e detyrimeve, prandaj edhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet dhe provat e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, si në pikën IV të dispozitivit të këtij vendimi, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452.2, e lidhur me nenin 463 të LPK-së, duke marrë parasysh suksesin e paditësit në këtë procedurë, e kërkesën e specifikuar për këto shpenzime, kurse sa i përket lartësisë së shpenzimeve të procedurës të cilat i ka aprovuar palës paditëse gjykata është bazuar në nr. tarifor 6 dhe 7, të Rregullorës për Tarifën e Avokatëve të Kosovës, duke ia njohur edhe atë: në emër të ushtrimit të padisë shumë prej 104.00 euro, në emër të taksës gjyqësore shumë prej 40.00 euro, në emër të 3 seancave të mbajtura me nga 135.20 euro për një seancë, gjithsej 405.60 euro, dhe në emër të dy ekspertizave shumë prej 300.00 euro e në shumë të përgjithshme prej 849.60 euro.

Nga të lartëcekurat më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 143 par. 1 të LPK-së.

Gjykata Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm
C. nr.1033/2018, më datë 26.03.2024

Gjyqtarja,

Florije Qerimi

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi. Ankesa në kopje të mjaftueshme dorëzohet përmes kësaj gjykate.